

## Informata të përgjithshme për Shpellën e Gadimes

MNRV Shpella e Gadimes” – Monument i Natyrës me Rëndësi të Veçantë, ndodhet në fshatin Gadime e Ulët të Komunës së Lipjanit, 3 km larg rrugës magjistrale Prishtinë- Ferizaj- Shkup. Shpella me kanalet e saj është e lokalizuar në sukën e “Mërturit”, ndërsa hyrja ndodhet në pjesën e poshtme të grykës së lumit Klytura në lartësi mbidetare 580 m.

Është zbuluar në vitin 1967 nga Ahmet Asllani. Pas zbulimit shpella është marrë nën mbrojtje ligjore– 1969, me sipërfaqe të përgjithshme prej 38.6 ha. Për shkak të vlerave të mëdha, stolive, dukurive shpellore interesante dhe pozitës së përshtatshme shpella përgatitet dhe hapet për vizitor në vitin 1976.

Shpella e Gadimes është shpella më e njohur në Kosovë, dhe aktualisht është e vetmja e përgatitur për vizitor në Kosovë. Pasuri e shpellës të cilat e bëjnë të veçante janë prezencën e aragoniteve të cilat si stoli shpellor janë dukuri të rralla. Kristalet e këtyre stolive, në shpellë paraqiten në galerinë e Aragoniteve të cilat karakterizohen me forma dhe drejtime të ndryshme të shtrirjes të cilat shpellën e bëjnë posaçërisht interesante dhe tërheqëse.

Në aspekt hidrologjik shpella e Gadimes është e pasur me ujëra nëntokësore. Në të nijetin horizont paraqiten të gjitha llojet e ujërave të shpellave: ujërat e kondensuar, pikues, rrjedhës dhe qëndruës duke e shndërruar shpellën e Gadimes në objekt të veçantë në aspekt hidrologjik.

Shpella e Gadimes paraqet fenomen karstik unik jo vetëm në Kosovë por edhe më gjerë. Është e zhvilluar në një thjerrëz të gëlqerorëve me moshë paleozoike të mermerizuar me dimensione të vogla hapësinore e ndërfaqe në rreshtet permo-triasike. Fakti se kanalet, galeritë dhe boshllëqet e kësaj shpelle janë krijuar në mermer paleozoiku e bënë këtë shpellë raritet edhe me përmasa botërore.




### Orari i vizitave në shpellë


Vizitat në shpellë	Hyrja ne shpellë	Dalja nga shpella
Termini 1	08:30	09: 00
Termini 2	09: 00	09: 30
Termini 3	09: 30	10: 00
Termini 4	10: 00	10: 30
Termini 5	10: 30	11: 00
Termini 6	11: 00	11: 30
Termini 7	11: 30	12: 00
Pauza e drekës	12: 00	13: 00
Termini 8	13: 00	13: 30
Termini 9	13: 30	14: 00
Termini 10	14: 00	14: 30
Termini 11	14: 30	15: 00
Termini 12	15: 00	15: 30
Termini 13	15: 30	16: 00

### Çmimorja

Nr.	Kategoria e vizitorëve	Çmimi
1.	Të rriturit	2 euro
2.	Fëmijët 7 -16 vjeç	1 euro
3.	Grupet e organizuara të nxënësve	1 euro
4.	Fëmijët nën moshën 6 vjeçarë	Gratis
5.	Të gjitha kategoritë e personave me aftësi të kufizuar	Gratis



Harta e hapësirave të brendshme të Shpellës së Gadimes



Pozita gjeografike e lokacionit të vendndodhjes së Shpellës së Gadimes